

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### LICENCIME

Gjatë muajit shtator, Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurat për rinovimin e licencës së shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sha, në veprimtarinë e tregtimit dhe të furnizimit të energjisë elektrike. Shoqëria është mbajtëse e një licence tregëtimi dhe furnizimi që nga vitit 2019.

Përfaqësues të Entit Rregullator të Energjisë gjatë muajit shtator morën pjesë në Iniciativën Rajonale të Gazit të organizuar nga Agjensia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER), si dhe në Gas Forum 2023 të organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Gjatë këtyre aktiviteteve të zhvilluara në Vienë, u diskutua mbi zhvillimet e sektorit gjatë verës 2023, mbi planin e punës për periudhën 2023 – 2025 dhe propozime mbi çështje të reja.

Fokus i veçantë iu dha gjithashtu përditësimeve mbi paketën e dekarbonizimit të gazit, dizenjimin e një kornize rregullatore të avancuar në këtë sektor si dhe sigurimin e rezervave të gazit për periudhën 2023/2024 dhe eliminimin gradual të gazit rus.

### AKTIVITETE

ERRA, Organizata e rregullatorëve rajonalë të energjisë, ka publikuar raportin e implementimit të sistemit të garancive të origjinës. Ky raport i cili ka përpunuar të dhënat e gjeneruara nga vendet pjesëmarrëse ka arritur të kryejë një analizë të situatës faktike të integritit të sistemit të garancive të origjinës në vendet e Rajonit. Shqipëria është ndër vendet që ka një regjistër të Garancive të Origjinës e që për qëllime të çertifkimit të energjisë së rinovueshme, ka marrë një sërë vendimmarrjesh në miratim të kërkesave të prodhuesve që plotësojnë kriteret ligjore dhe teknike. Rregjistrin e GO, gjendet i publikuar e azhurnuar në faqen zyrtare të ERE. Po ashtu në këtë raport evidentohet se ERE është bërë pjesë e regjistrin rajonal të Garancive, një initiative e Sekretariatit të Komunitetit të Energjiave. Rregjistrin e Garancive të Origjinës Shqipëtare, e gjeni të publikuar e azhurnuar në faqen zyrtare të ERE, në kategorinë "Licencime".

[Raporti gjendet i publikuar në linkun https://shorturl.at/imqA1](https://shorturl.at/imqA1)

# NEWSLETTER

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### MBLEDHJE BORDI

Po këtë muaj, Bordi i ERE-s ka zhvilluar katër mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 16 vendimmarrje, ndër të cilat, licencimi i një subjekti në prodhimin e energjisë elektrike nga central fotovoltaik, si dhe miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Gusht 2023 prej 15.80 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, por dhe vendime mbi çështje të brendshme të organizimit të institucionit.

Gjithashtu, ndër vendimarrjet me rëndësi të marra gjatë këtij muaji vlen të përmendim miratimin e rregullores “Mbi pezullimin dhe rivendosjen e aktivitetit të tregut, rregullave për shlyerjen e disbalancave, kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, për periudhën gjatë së cilës aktivitetet e tregut janë pezulluar”. Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen e parimeve dhe përcaktimin e procedurës së komunikimit që OST sh.a. duhet të ndjekë në rast se duhet të pezullojë për kohësisht një ose më shumë nga aktivitetet e tregut apo rivendosë aktivitetet e pezulluara të tregut si dhe rregullat për faturimin dhe shlyerjen e disbalancës dhe faturimin dhe shlyerjen e kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese të cilat do të jenë të aplikueshme për faturimin dhe shlyerjen e disbalancave për periudhat gjatë të cilave aktivitetet e tregut janë pezulluar në përputhje me dispozitat për Rregullat për shlyerjet në rast të pezullimit të aktivitetet e tregut në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Kodin e Transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 63, datë 12.04.2022.

Pjesë e axhendës mujore kanë qënë dhe seancat dëgjimore që lidhen me zgjidhjet e mosmarrëveshjeve mes të licencuarve, diskutime të palëve të interesit për çmime të përcaktuara nga ERE apo zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

Për t'u azhurnuar me informacion më të detajuar, shfletoni faqjen tonë zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) si dhe publikimet periodike në rrjetet sociale.